



Në bazë të Programit për propagandë të përgjithshme turistike dhe për përmirësimin e kushteve për qëndrimin e turistëve në qytetin e Shkupit në vitin 2022 ("Lajmëtari Zyrtar i Qytetit të Shkupit" nr. 02/22), Qyteti i Shkupit shpall:

THIRRJE PUBLIKE

për mbledhjen e aplikimeve për mbështetje financiare për realizimin e projektit - Shtimi i fondit të peshqve në lumenjtë dhe liqenet në Shkup

Alokimi i mjeteve nga Buxheti i Qytetit të Shkupit për vitin 2022 (nënprogrami G2, zëri 464, nënzëri 464990) - të dedikura për mbështetje financiare për realizimin e projektit – Shtimi i fondit të peshqve në lumenjtë dhe liqenet në Shkup për vitin 2022, do të kryhet në bazë të Programit për propagandë të përgjithshme turistike dhe për përmirësimin e kushteve për qëndrim të turistëve në qytetin e Shkupit për vitin 2022 (Lajmëtari Zyrtar i Qytetit të Shkupit nr. 02/22).

1. Lëndë e Thirrjes publike

Lëndë e Thirrjes publike është mbështetja financiare për realizimin e projektit - Shtimi i fondit të peshqve në lumenjtë dhe liqenet në Shkup në vitin 2022.

2. Mjetet e parashikuara

Për mbështetjen financiare për realizimin e projektit - Shtimi i fondit të peshqve në lumenjtë dhe liqenet në Shkup për vitin 2022 janë parashikuar mjete me vlerë të përgjithshme 600.000,00 denarë.

Mjetet ndahen nga Buxheti i Qytetit të Shkupit për vitin 2022 dhe janë parashikuar në Programin për propagandë të përgjithshme turistike dhe për përmirësimin e kushteve për qëndrimin e turistëve në qytetin e Shkupit në vitin 2022.

3. Pjesëmarrja në Thirrjen publike

Të drejtë për pjesëmarrje në këtë Thirrje publike kanë të gjitha shoqatat civile, fondacionet, federatat, institucionet dhe shoqëritë tregtare të cilat janë regjistruar sipas Ligjit për Shoqata dhe Fondacione dhe Ligjit për Shoqëritë Tregtare.

4. Aplikuesi duhet t'i përmbush kriteret e mëposhtme për përzgjedhjen e subjektit i cili do ta realizojë projektin - Shtimi i fondit të peshqve në lumenjtë dhe liqenet në Shkup

KRITERE	Numri maksimal i pikëve
1. Përvojë e aplikantit në zbatimin dhe realizimin e projekteve të njëjta ose të ngjashme.	40
1.1. Biografia profesionale e ekspertëve që do të angazhohen në realizimin e projektit;	10

1.2. Biografia e personave të jashtëm (të pavarur) që do të mbikëqyrin plotësisht procesin e shtimit të fondit të peshqve	10
1.3. Lista referuese e projekteve (aktiviteteve) të njëjta ose të ngjashme të përfunduara deri më tani;	10
1.4. Të paktën dy opinione/referenca nga partnerë ose donatorë për zbatimin e projekteve të mëparshme me qëllim të njëjtë ose të ngjashëm;	10
2. Plani i detajuar financiar për mjetet e nevojshme për realizimin e projektit dhe arsyetimi i shpenzimeve në planin financiar të propozuar.	20
2.1. A është real plani financiar i propozuar (Përshkrimi i shpenzimeve sipas pozicioneve të kategorive korrespondon me çmimet e tregut - plani financiar i detajuar;	10
2.2. A siguron organizata përqindje të pjesëmarrjes së saj në realizimin e projektit;	10
3. Plani për realizimin e aktiviteteve të parashikuara* për shtimin e fondit të peshqve në lumenjtë dhe liqenet në Shkup dhe kapaciteti i organizatës për kryerjen e aktiviteteve të parashikuara.	40
3.1. Mbështetje me shkrim nga organizata apo institucione të tjera që planifikohen të marrin pjesë në zbatimin e projektit (Instituti i Blegtorisë - Instituti i Peshkimit, IPP Instituti Hidrobiologjik ose miratimi i Inspektoratit Shtetëror të Bujqësisë - Seksioni i Peshkimit)	10
3.2. Dëshmi që aplikanti ka siguruar ose do të sigurojë material për shtimin e fondit të peshqve (letër mbështetjeje ose kontratë paraprake) me një person juridik të autorizuar për të prodhuar material për shtimin e fondit të peshqve;	10
3.3. A është plani i zbatimit të projektit i qartë dhe i arritshëm?	10
3.4. A zotëron organizata apo merr me qira automjete të specializuara për transferimin e materialit për shtimin e fondit të peshqve;	10
Numri maksimal i pikëve	100

* Çdo fushë e kriteve të veçanta do të vlerësohet me 1 pikë, 5 pikë ose 10 pikë, me kuptimin e mëposhtëm: 1-jo, 5-pjesërisht dhe 10-po.

Vërejtje: Nën termin aktiviteteve të parashikuara në pikën 3.2 të kriteve të Thirrjes publike konsiderohen:

Aktivitete sipas projektit	Pesha (madhësia) për copë	Pesha mesatare për copë në kg	Numri i peshqve	Material për shtimin e fondit të peshqve në kilogram
Shtimi i fondit të peshqve me material shtimi (peshk) – trofta endemike maqedonase(Salmo macedonicus Karaman,1924)	nga 20 gramë deri më 50 gramë	0,04	2800	nga 105 deri më 115
Shtimi i fondit të peshqve me material shtimi (peshk) – trofta endemike maqedonase(Salmo macedonicus Karaman,1924)	nga 50 gramë deri më 200 gramë	0,15	1200	nga 175 deri më 185

Shtimi i fondit të peshqve me material shtimi (peshk) – krap (cyprinus carpio) dhe lloje të tjera autoktone të peshkut të bardhë që jeton në ujëra të ëmbla	nga 500 gramë deri më 800 gramë	0,7	800	nga 555 deri më 565
---	---------------------------------	-----	-----	---------------------

Në procedurën për alokimin e mjeteve buxhetore nga Programi për propagandë të përgjithshme turistike dhe për përmirësimin e kushteve për qëndrimin e turistëve në qytetin e Shkupit për vitin 2022, do të shqyrtohen ato projekte të cilat në bazë të kriterëve do të sigurojnë të paktën 80 pikë.

5. Dokumentacioni i nevojshëm, të cilin aplikuesi duhet ta depozitojë të bashkëngjitur me Aplikimin për mbështetje financiare

Përveç aplikimit për mbështetje financiare i cili duhet të plotësohet në mënyrë digjitale me shkronja shtypi të alfabetit cirilik, të nënshkruar nga personi kompetent dhe të vërtetuar me vulën e shoqatës, fondacionit, federatës, shoqërisë tregtare ose institucionit, aplikuesi detyrimisht duhet t'i depozitojë edhe bashkëngjitjet e mëposhtme:

- Gjendja vijuese nga Regjistri Qendror ose Aktvendim për regjistrimin e shoqatës apo fondacionit;
- Vërtetim se nuk u ndalohet pjesëmarrja në procedurat e thirrjeve publike, dhënies së kontratave të prokurimit publik dhe kontratave të partneritetit publik-privat (Regjistri Qendror);
- Propozim-projekt i plotësuar në mënyrë digjitale me shkronja shtypi të alfabetit cirilik;
- Plan financiar i plotësuar në mënyrë digjitale me shkronja shtypi të alfabetit cirilik;
- Deklaratë se për aktivitetet e theksuara në projekt deri më tani nuk janë shfrytëzuar mjete nga Qyteti i Shkupit për vitin 2022, që do të nënkuptonte financim të dyfishtë të të njëjtave aktivitete nga të njëjtat burime, në vitin në vijim;
- Deklaratë e nënshkruar për detyrimet e shlyera ndaj Qytetit të Shkupit (tatime, taksa komunale)
- Vërtetim se nuk ka ndalim për pjesëmarrje në procedurat e thirrjeve publike, dhënies së kontratës së prokurimit publik dhe kontratave të partneritetit publik-privat.

6. Dokumentacioni i nevojshëm, të cilin aplikuesi duhet ta depozitojë të bashkëngjitur me projektin e propozuar

Aplikuesit si bashkëngjitje të propozim - projektit duhet të depozitojnë edhe këto dokumente shoqëruese:

- biografi profesionale të ekspertëve që do të angazhohen në realizimin e projektit;

- biografi e personave të jashtëm (të pavarur) të cilët do të mbikëqyrin plotësisht procesin e shtimit të fondit të peshqve;
- buxhet vjetor i aplikuesit për vitin aktual;
- listë referimi për projekte (aktivitete) të njëjta apo të ngjashme të realizuara deri më tani;
- më së paku dy opinione/referenca nga partnerë ose donatorë për realizimin e projekteve të mëparshme të njëjta ose me qëllim të ngjashëm;
- mbështetje me shkrim nga organizata tjera ose institucione për të cilat është planifikuar që të marrin pjesë në realizimin e projektit (Instituti i Blegtorisë – enti i peshkimit, Instituti Hidrobiologjik ose miratimi i Inspektoratit Shtetëror i Bujqësisë – Seksioni i peshkimit)
- Dëshmi që aplikuesi ka siguruar ose do ta sigurojë materialin për peshkim;

Vërejte: Aplikimet me dokumentacion jo të plotë ose që do të depozitohen pas përfundimit të afatit të parashikuar nuk do të shqyrtohen! Bashkëngjitjet e depozituara nuk kthehen.

7. Fusha me përparësi të projektit – Shtimi i fondit të peshqve në lumenjtë dhe liqenet në Shkup

Fusha me përparësi të projektit janë:

- Zhvillimi i turizmit të peshkimit sportiv në qytetin e Shkupit;
- Promovimi i turizmit të peshkimit sportiv;
- Pasurimi i fondit të peshqve në lumenjtë dhe liqenet në Shkup;
- Rikthimi i troftës maqedonase (*Salmo macedonicus* Karaman, 1924) dhe i krapit (*Cyprinus carpio*);
- Pasurimi i ofertës turistike të qytetit të Shkupit nëpërmjet zhvillimit të këtij lloji të turizmit sportiv si pjesë e turizmit ekologjik;

8. Periudha dhe vendi i realizimit të projektit

Projekti do të realizohet deri në muajin dhjetor në vitin 2022.

Vende të parashikuara për shtimin e fondit të peshqve:

- Lumi Vardar - Troftë endemike (*Salmo macedonicus* Karaman, 1924)
- Liqeni i Treskës - Troftë endemike (*Salmo macedonicus* Karaman, 1924)
- Liqenet në Parkun e qytetit - Krap (*cyprinus carpio*)

9. Mënyra e realizimit të Thirrjes publike

Kryetarja e Qytetit me Aktvendim formon Komisionin për realizimin e Thirrjes publike.

Komisioni shqyrton dhe vlerëson aplikimet e arritura për mbështetje financiare dhe dokumentacionin e depozituar si shtojcë për realizimin e projektit për shtimin e fondit të peshqve në lumenjtë dhe liqenet në Shkup për vitin 2022, përgatit procesverbal dhe i njëjti i depozitohet pranë kryetares së Qytetit të Shkupit.

Aplikuesit do të njoftohen për rezultatet në një afat prej **15 ditësh** nga dita e përfundimit të Thirrjes publike.

Aplikuesi i cili ka përmbushur kriteret në përputhje me Thirrjen publike do të lidhë kontratë për ndarjen e mjeteve financiare me Qytetin e Shkupit.

10. Afati dhe mënyra e depozitimit të aplikimeve

Afati për depozitimin e aplikimeve është **10 ditë pune** nga dita e shpalljes së Thirrjes publike. Thirrja publike shpallet më **06.06.2022** dhe zgjat deri më **20.06.2022**.

Aplikimi së bashku me dokumentacionin duhet të depozitohet në zarf të mbyllur dhe të vulosur në adresën: **Qyteti i Shkupit, Sektori për Zhvillim Lokal Ekonomik, bul. "Ilinden" nr. 82, 1000 Shkup** (me shënimin - Aplikim për Thirrje publike për mbështetje financiare për realizimin e projektit - Shtimi i fondit të peshqve në lumenjtë dhe liqenet në Shkup, Sektori për Zhvillim Lokal Ekonomik)

Aplikimi për mbështetje financiare dhe konstruksioni financiar janë në dispozicion në ambientet e Qytetit të Shkupit, Seksioni për mbështetjen e zhvillimit të turizmit dhe hotelerisë.

Pyetje sqaruese mund të parashtrohen me shkrim ose në mënyrë elektronike pranë Sektorit për Zhvillim Lokal Ekonomik.

Telefoni për kontakt: (02) 3297-272 dhe (02) 3297-218 - Sektori për Zhvillim Lokal Ekonomik

QYTETI I SHKUPIT